



ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Zgjedhjet parlamentare paraqesin mekanizma demokratike, me ndihmën e të cilëve zgjidhen deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, i cili është organ njëdhomësh përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit ligjvënës në Republikën e Maqedonisë.

Nëpërmjet këtij mekanizmi populli ia beson ushtrimin e pushtetit politik, organit përfaqësues i cili pastaj e prezanton vullnetin e vetë sovran. Elektorati e mundëson kalimin e sovranitetit nga qytetarët te përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike.

Parimet themelore të zgjedhjeve parlamentare janë të rregulluara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ndërsa mënyra, kushtet dhe procedurat për zgjedhje të deputetëve janë të rregulluara me Kodin Zgjedhor.

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Kuvendi përbëhet nga 120 deri në 140 deputetë. Numri i saktë i deputetëve është verifikuar në Kodin Zgjedhor dhe ai numër deri në vitin 2008, ishte 120, kurse më pas numri i deputetëve u zmadhua në 123.

Deputetët marrin mandate 4 vjeçare në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votime të fshehta.

Zgjedhjet parlamentare zhvillohen çdo katër vjet gjatë 90 ditëve të fundit të mandatit të përbërjes së vjetër të deputetëve, ndërsa ato i shpall kryetari i Kuvendit.

Zgjedhjet parlamentare zhvillohen edhe në rast të vetëshpërbërjes së Kuvendit (zgjedhje të parakohshme), nëse për të deklarohen shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në këtë rast, zgjedhjet zhvillohen, në afat prej 60 ditësh nga dita e shpërbërjes së Kuvendit.

E DREJTA E VOTIMIT

E drejta aktive e votimit

Të drejtë për votim ka secili shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili ka mbushur 18 vjeç, ka kapacitet juridik dhe ka adresë të përhershme në njësinë zgjedhore, në të cilën ka votime.

Në zgjedhjet për deputetë votojnë edhe qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët në ditën e zgjedhjeve janë me punë dhe qëndrim të përkohshëm jashtë vendit. Të drejtën për votim ata e realizojnë në përfaqësitë diplomatike konsullore të Republikës së Maqedonisë në vendet ku qëndrojnë ose punojnë.

Votimi nuk është i detyrueshëm.

E drejta pasive e votimit

Kandidat për deputet mund të jetë çdo shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili ka mbushur 18 vjeç, ka kapacitet juridik dhe nuk është duke vuajtur dënim me burg për kryerje të veprës penale, gjegjësisht nuk është dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, ndërsa ende nuk ka filluar ta vuajë dënimin.

MODELET ZGJEDHORE

Modeli zgjedhor paraqet një përmbledhje të rregullave, në bazë të së cilave votat e elektoratit shndërrohen në mandate deputetësh.

Ekzistojnë dy modele themelore zgjedhore (me variacione të ndryshme potenciale): modeli zgjedhor mazhoritar dhe modeli proporcional zgjedhor.

Sipas modelit zgjedhor mazhoritar në secilën njësi zgjedhore zgjidhet nga një deputet, kështu që numri

i njësive zgjedhore është i barabartë me numrin e vendeve të deputetëve. Votuesi jep votën për njërin nga kandidatët, të cilët gjenden në fletëvotim. Mandati i deputetit në secilën njësi zgjedhore i takon kandidatit, i cili do të fitojë numrin më të madh të votave (shumicë relative ose absolute).

Sipas modelit proporcional në çdo njësi zgjedhore zgjidhen deputetë, ndonëse numri i njësive zgjedhore mund të jetë i ndryshëm. Në këtë sistem votuesi voton për listën e kandidatëve (listë e partisë politike, koalicionit ose listë e kandidatëve të pavarur), kurse shpërndarja e mandateve bëhet ndërmjet kandidatëve ose partive politike, sipas përfaqësimit proporcional të votave të fituara nga numri i përgjithshëm i votave.

MODELET ZGJEDHORE PARLAMENTARE TË MAQEDONISË (1990 - 2014)

Zgjedhjet e para demokratike shumëpartiake në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë zhvilluar më 11 nëntor të vitit 1990, menjëherë pas fillimit së pluralizmit politik në shtator të të njëjtit vit.

Zgjedhjet e para parlamentare janë zhvilluar në vitin 1994, pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991.



Pulla postare e Postës së Maqedonisë me rastin e 20 vjetorit të zgjedhjeve të para shumëpartiake në Maqedoni

(FDC 19/2010, 11 nëntor, 2010)

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1990 dhe 1994 shpërndarja e mandateve të deputetëve është bërë sipas modelit zgjedhor mazhoritar me shumica absolute (në rrethin e parë) dhe shumicë relative (në rrethin e dytë). Në këto zgjedhje deputetët janë zgjedhur në bazë të parimit: një mandat deputeti – një njësi zgjedhore.

Në vitin 1998 është braktisur dominimi absolut i modelit mazhoritar dhe është zbatuar modeli i kombinuar zgjedhor: 85 deputetë janë zgjedhur sipas modelit mazhoritar, ndërsa 35 sipas modelit proporcional. Njësia zgjedhore, në të cilën janë shpërndarë 35 mandatet e deputetëve sipas modelit proporcional ka qenë i tërë territori i Republikës së Maqedonisë. Shpërndarja e mandateve është bërë në bazë të Modelit të Dontit, me prag zgjedhor prej 0,5%.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 aplikohet modeli proporcional për ndarjen e të gjitha 120 vendeve të deputetëve, ku territori i Republikës së Maqedonisë është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore, kurse nga çdo njësi zgjedhore zgjidhen nga 20 deputetë. Që të sigurohet përfaqësim më i lartë i grave në Kuvend, për herë të parë aplikohet kuota prej 30% si garanci për pjesëmarrje të gjinisë e cila është e përfaqësuar më pak. I njëjti model është përdorur edhe gjatë mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 edhe në zgjedhjet e

parakohshme parlamentare të vitit 2008 (zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2008 janë zgjedhjet e para të parakohshme të organizuara në Republikën e Maqedonisë).

Në pajtim me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2008, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë zgjidhen 123 deputetë. Sipas modelit proporcional zgjidhen 120 deputetë, ku territori i Republikës së Maqedonisë është i ndarë në gjashtë njësi zgjedhore, ndërsa në çdo njësi zgjedhore zgjidhen nga 20 deputetë.

Tre deputetë zgjedhin shtetasit e Republikës së Maqedonisë të cilët në ditën e zgjedhjeve përkohësisht janë duke punuar ose banojnë përkohësisht jashtë vendit. Këta tre deputetë zgjidhen sipas modelit të mazhorancës, edhe kjo nga një deputet për çdo njësi zgjedhore: një njësi zgjedhore në Evropë dhe Afrikë, tjetra në Amerikën Veriore dhe Jugore, edhe e treta njësi zgjedhore në Australi dhe Azi.

Ky model zgjedhor për herë të parë aplikohet gjatë mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2011. Në këto zgjedhje qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët punojnë ose banojnë përkohësisht jashtë vendi fituan për herë të parë të drejtën e votimit. I njëjti model zgjedhor është aplikuar edhe në zgjedhjet e treta të parakohshme parlamentare të mbajtura në vitin 2014.

KANDIDATËT PËR DEPUTETË

Propozimi i kandidatëve për deputetë bëhet me dorëzimin e listës së kandidatëve për deputetë. Të drejtën e dorëzimit të listës së kandidatëve për deputetë e kanë partitë politike të regjistruara, edhe atë, në mënyrë të pavarur (një parti), si koalicion, ose si grup votuesish.

Kur paraqitësi i listës së kandidatëve për deputetë është grup votuesish, është e nevojshme që të mblidhen minimum 1.000 nënshkrime nga zgjedhësit e regjistruar në Listën zgjedhore të njësive zgjedhore.

FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore është paraqitja publike e kandidatëve dhe e programeve të tyre gjatë periudhës parazgjedhore, objektivi i të cilëve është ndikimi mbi vendimin e zgjedhësve gjatë votimit (evenimente publike, shfaqja publike e posterave, video prezantime në vende publike, paraqitja në media dhe në internet, shpërndarja e materialeve të shtypura).

Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para mbajtjes së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve.

Organizatorët e fushatës zgjedhore kanë të drejtë që në kushte të njëjta t'i përdorin të gjitha llojet e propagandave politike. Gjatë fushatës zgjedhore Shërbimi Publik i Radiodifuzionit është i detyruar

të transmetojë falas paraqitjen politike të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor.

VOTIMI

Votimi për zgjedhjet parlamentare fillon në ora 7,00 të mëngjesit dhe vazhdon pandërprerë deri në ora 19,00.

Zgjedhësit të cilët në ditën e votimit janë përkohësisht me punë ose banim jashtë vendit votojnë në selitë diplomatike-konsullore, një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë. Votimi mbahet në të njëjtin interval kohor nga ora 7,00 deri 19,00, sipas matjes së kohës në vendin përkatës. Një ditë para zgjedhjeve votojnë edhe personat të cilët janë në paraburgim ose mbajnë dënimin me burg, si dhe të zhvendosurit e brendshëm, të sëmurit dhe personat e paaftë.

MBLEDHJA E REZULTATEVE DHE NDARJA E MANDATEVE TË DEPUTETËVE

Rezultatet përfundimtare të votimit i vërteton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve mbi bazën e procesverbaleve me rezultatet e mbledhura nga çdo komision komunal zgjedhor. Rezultatet vërtetohen veçmas për çdo njësi zgjedhore.

Në secilën nga tri njësitë zgjedhore jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë, për deputet zgjidhet ai kandidat i cili ka fituar shumicën e votave nga zgjedhësit që kanë votuar, por jo më pak se 2% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore.

Në gjashtë njësitë zgjedhore në territorin e Republikës së Maqedonisë, ku zgjedhjet mbahen sipas modelit proporcional, ndarja e mandateve të deputetëve bëhet sipas Formulës së Dontit, pa prag zgjedhor:

$$\frac{V}{s + 1}$$

V paraqet numrin e përgjithshëm të votave të cilat i ka fituar lista zgjedhore, ndërsa S paraqet numrin e mandateve/vendeve të cilat i ka fituar lista (në fillim 0 për të gjitha listat, ndërsa procedura përsëritet deri në ndarjen e mandateve).

Sipas Sistemit të Dontit, numri i votave nga çdo listë zgjedhore ndahet me 1, 2, 3, 4.....n (n është numri i vendeve të deputetëve në njësinë

zgjedhore). Koeficientet e fituara renditen sipas madhësisë së tyre, ku merren parasysh koeficientet më të mëdha aq sa mandate ka në njësinë zgjedhore. Çdo listë fiton aq mandate, aq sa nga votat e fituara ka koeficiente më të mëdha. Mandatet ndahen sipas renditjes së kandidatëve të listës.

Për shembull, të supozojmë se në zgjedhjet në një njësi zgjedhore, në të cilën zgjidhen gjashtë përfaqësues, marrin pjesë katër lista partiake. Lista A ka fituar 330.898 vota, lista B 212.512, lista C 154.926 dhe lista D 99.730 vota. Rezultatet zgjedhore në secilën listë ndahen me 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

| Lista A | Lista B |
|---------------------|----------------------------|
| 330.898:1 = 330.898 | 212.512:1 = 212.512 |
| 330.898:2 = 165.449 | 212.512:2 = <u>106.256</u> |
| 330.898:3 = 110.299 | 212.512:3 = 70.837 |
| 330.898:4 = 82.724 | 212.512:4 = 53.128 |
| 330.898:5 = 66.179 | 212.512:5 = 42.502 |
| 330.898:6 = 55.149 | 212.512:6 = 35.418 |
| Lista C | Lista D |
| 154.926:1 = 154.926 | 99.730:1 = 99.730 |
| 154.926:2 = 77.463 | 99.730:2 = 49.856 |
| 154.926:3 = 51.642 | 99.730:3 = 33.243 |
| 154.926:4 = 38.731 | 99.730:4 = 24.932 |
| 154.926:5 = 30.985 | 99.730:5 = 19.946 |
| 154.926:6 = 25.821 | 99.730:6 = 16.621 |

Nga të gjitha rezultatet, rezultati i gjashtë sipas madhësisë është 106.256, që njëkohësisht paraqet edhe pjesëtues i përbashkët me të cilin ndahen rezultatet e përgjithshme nga çdo listë, edhe atë:

$$\text{Lista A} - 330.898:106.256=3$$

$$\text{Lista B} - 212.512:106.256=2$$

$$\text{Lista C} - 154.926:106.256=1$$

$$\text{Lista D} - 99.730:106.256=0$$

Nga shembulli rezulton se partia A do të fitojë tre mandate, partia B do të fitojë dy mandate, partia C një mandat, ndërsa partia D nuk do të fitojë asnjë mandat.

Zgjedhjet parlamentare 1994

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara | Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|-----------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|
| Lidhja për Maqedoninë | 87 | PL | 5 |
| PPD | 10 | LSDM | 1 |
| PDP | 4 | PSDM | 1 |
| PDM | 1 | PSM | 1 |
| Kandidatë të pavarur | 6 | PAD-PDTM | 1 |
| PEPR | 2 | LSDM-PL | 1 |
| | | Gjithsej | 120 |

Zgjedhjet parlamentare 1998

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|------------------|------------------------------|
| VMRO-DPMNE | 49 |
| LSDM | 27 |
| PPD-PDP | 25 |
| PLD-PDM | 4 |
| PSM | 1 |
| AD | 13 |
| LRM | 1 |
| Gjithsej | 120 |

Zgjedhjet parlamentare 2002

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|-------------------------------------|------------------------------|
| Koalicioni për Maqedoninë së bashku | 60 |
| VMRO-DPMNE – PL | 33 |
| BDI | 16 |
| PDSH | 7 |
| PPD | 2 |
| PDP | 1 |
| PSM | 1 |
| Gjithsej | 120 |

Zgjedhjet parlamentare 2006

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|-------------------------------------|------------------------------|
| Koalicioni për Maqedoni më të mirë | 45 |
| Koalicioni për Maqedoninë së bashku | 32 |
| BDI-PPD- LDB | 17 |
| PDSH | 11 |
| PSDR | 7 |
| VMRO-PP | 6 |
| DOM | 1 |
| PAE | 1 |
| Gjithsej | 120 |

Zgjedhjet parlamentare 2008

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|------------------------------------|------------------------------|
| Koalicioni për Maqedoni më të mirë | 63 |
| Dielli - Koalicion për Evropë | 27 |
| BDI | 18 |
| PDSH | 11 |
| PAE | 1 |
| Gjithsej | 120 |

Zgjedhjet parlamentare 2011

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|-----------------------|------------------------------|
| Koalicioni VMRO-DPMNE | 56 |
| Koalicioni LSDM | 42 |
| BDI | 15 |
| PDSH | 8 |
| RDK | 2 |
| Gjithsej | 123 |

Zgjedhjet parlamentare 2014

| Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara | Entiteti politik | Numri i mandateve të fituara |
|------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|
| VMRO-DPMNE etj. | 61 | PDSH | 7 |
| LSDM etj. | 34 | RDK | 1 |
| BDI | 19 | GROM | 1 |
| | | Gjithsej | 123 |

Partitë politike:

VMRO-DPMNE - VMRO Partia Demokratike për Unitet

Nacional Maqedonas

LSDM- Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

BDI- Bashkimi Demokratik për Integrim

PDSH – Partia Demokratike Shqiptare

PLD - Partia Liberal Demokratike

PSM – Partia Socialiste e Maqedonisë

PAE – Partia për Ardhmëri Evropiane

PPD – Partia për Prosperitet Demokratik

RDK – Rilindja Demokratike Kombëtare

AD – Alternativa Demokratike

Koalicione:

Dielli Koalicioni për Evropë – LSDM, PLD, PSDR, PL, Alternativa e Re

Koalicioni për Maqedoninë së bashku – LSDM, PLD, PDTM, PBRM, LBM, PDSM.

Koalicioni për Maqedoni më të mirë – VMRO –DPMNE, PSM, LD, DOM, PDSM, PDTM, PBRM, VMRO-Maqedonase .

Lidhja për Maqedoninë – LSDM, PL, PSM.

GROM – Opsioni Qytetar për Maqedoni

DOM – Rimëkëmbja Demokratike e Maqedonisë

LS- Lidhja Demokratike

PSDR – Partia Socialdemokrate e Re

PL- Partia Liberale

PDM – Partia Demokratike e Maqedonisë

LDB – Liga Demokratike e Boshnjakëve

PADM– Partia për Aksion Demokratik e Maqedonisë

PDTM – Partia Demokratike e Turqve të Maqedonisë

PDSM- Partia Demokratike e Serbëve të Maqedonisë


PURM – Partia e Unitetit të Romëve të Maqedonisë

PEPR – Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve

PSDM – Partia Socialdemokrate e Maqedonisë

PAD – Partia për Aksion Demokratik

VMRO-PP –VMRO Partia Popullore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Ky dokument është punuar në suazat e Projektit "Vendosja dhe Zhvillimi i Institutit Parlamentar" të Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, i kofinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) me mbështetje këshillëdhënëse të Institutit Nacional Demokratik (NDI). Mendimet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC ose NDI.